

VENDIM
Nr. 71, datë 11.5.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 176, SERIA T12
TË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1 germa “e”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për rinovimin licencës së shoqërisë Danske Commodities Albania sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat “a”, është plotësuar tërësisht. Subjekti ka paraqitur në ERE vërtetimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të datës 19.04.2017, në të cilin thuhet se kjo shoqëri nuk ka detyrime tatimore për tatimin mbi fitimin, kontribute të sigurimeve shoqërore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, tatim të mbajtur në burim.
- Neni 9, pika 3, germat “b”, “c”, “d”, është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti